



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 561/5 Prot.

Tiranë, më 09.06.2023

V E N D I M

Nr. 87, Datë 09.06.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 68, datë 02.05.2023, e z. M.R kundër Shoqërisë së Transportit “Urban Trans Vlorë” dhe Bashkisë Vlorë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Për shkak të nevojave shëndetësore më është dashur që të përdor shërbimin publik të transportit urban dhe më është dashur që të paguaj biletë urbane sa herë që kam udhëtuar me linjën e urbanit brenda qytetit dhe më kanë thënë se shërbimi është me pagesë dhe ti nuk përjashtohesh nga kjo tarifë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave për eliminimin e pasojave që shkakton mosnjohja e të drejtës së tij për transport pa pagesë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

¹ Referuar Librezës nr. 18857, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, z. M.R është i verbër grupi II (dytë).

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 68, datë 02.05.2023, të bërë nga z. M.R, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 561/1, datë 09.05.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Vlorë dhe Shoqëria e Transportit Urban Trans Vlorë, për ankesën e bërë nga z. M.R, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Informacion nga ana e Shoqërisë “Urban Trans Vlorë” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
 - Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Urban Trans Vlorë” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.
 - Informacion nga ana e Bashkisë Vlorë, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e subjektit ankues.
 - Kopje të kontratës të shërbimit të lidhur mes Bashkisë Vlorë dhe Shoqërisë “Urban Trans Vlorë”.

Me shkresën datë 18.05.2023, Shoqëria “Urban Trans Vlorë”, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Shoqëria “Urban Trans Vlorë” e cila ushtron aktivitetin në transportin publik në Bashkinë Vlorë nuk u merr lekë personave të cilët kanë dokumente që përfitojnë nga ligji për udhëtim falas në urban. Nisur nga rasti, z. M.R ka patur një konflikt me faturinon për shkak të mungesës së raportit mjekësor. Nga ballafaqimi që patëm me zotërinë dhe përfaqësuesin e Bashkisë Vlorë, verifikuam rastin dhe e zgjidhem si problem². Ne ramë dakord që zotëria të udhëtojë pa pagesë në urban, por të jetë i pajisur me librezë dhe raport mjekësor. Ju bëjmë me dije se të gjithë personat që janë të pajisur me librezë dhe raporte mjekësore, udhëtojnë pa pagesë sipas ligjit dhe për këtë shërbim, ne si kompani nuk kemi marrë asnjë subvencion”.*

Me shkresën nr. 5646/1, datë 22.05.2023, Bashkia Vlorë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Bashkia Vlorë, Shoqëria “Urban Trans Vlorë” shpk dhe z. M.R, në datë 18.05.2023 patën diskutime dhe ballafaqime lidhur me shqetësimin e paraqitur nga qytetari, të cilit i kërkojnë të paguaj biletë në transportin urban dhe qytetari shpreh shqetësimin se është invalid i verbër i grupit të II dhe për këtë arsye nuk duhet të paguaj. Në këtë takim u arrit që ankuesi të udhëtojë falas në shërbimin urban, por duke qenë i pajisur gjithmonë me librezën e verbërisë së bashku me raportin mjeko ligjor.*

² Referuar procesverbalit datë 18.05.2023 të mbajtur mes ankuesit, përfaqësuesit të Bashkisë Vlorë dhe Administratorit të Shoqërisë Urban Trans Vlorë.

Në bazë të Kontratës për transport udhëtarësh në linjat urbanë nr. 1382, datë 20.02.2017, mes Bashkisë Vlorë dhe subjektit Urban Trans Vlora, në nenin 9 parashikohet se: “Kontraktori detyrohet që të garantojë udhëtimin e të gjithë kategorive të udhëtarëve që sipas legjislacionit përfitojnë lehtësira në udhëtim si: udhëtimi me bileta pajtimi (abone), udhëtimi pa pagesë kundrejt paraqitjes së dokumentacionit që parashikon ligji, etj.”, subjekti ta kryejë këtë transport urban sipas akteve nënligjore.

Me subjektin “Urban Trans Vlora” shpk, Bashkia Vlorë ka pasur korrespondenca lidhur me këtë shqetësim të qytetarëve ku janë pasqyruar në shkresat nr. 12982/1, datë 06.10.2021 dhe shkresa me nr. 12982/2, datë 11.10.2021 dhe është theksuar se ky subjekt, do të sigurojë lehtësi në qarkullimin e transportit urban të personave të verbër, ku këta persona do të udhëtojnë falas, kundrejt paraqitjes së dokumentit të verbërisë të lëshuar nga organet e autorizuar dhe raportet përkatëse.

Aktualisht ky shërbim kryhet falas nga subjekti “Urban Trans Vlora” shpk, për të gjithë personat e verbër, që disponojnë dokumentet e sipërcituara”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, ankuesi është kontaktuar me telefon nga inspektori i çështjes dhe është njohur me përgjigjen e Shoqërisë Urban Trans Vlorë.

Ankuesi z. M.R, me procesverbalin datë 29.05.2023, të dërguar nga Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, është tërhequr nga ankesa e bërë pranë KMD-së, pasi ka vlerësuar masat e marra nga Shoqëria “Urban Trans Vlorë”, pas ndërmjetësimit të Komisionerit, për zgjidhjen e ankesës së tij, lidhur me udhëtimin pa pagesë në linjën e transportit urban në qytetin e Vlorës.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 9 dhe 10, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 68, datë 02.05.2023, të z. M.R, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA